

“Mjedisi Sot”
Nr 2200 E Hene 24/09/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III
Kutia postare 127, Tirane
Tel/Faks (+355 4) 23 29 28
Email: info@albania.rec.org
Web: <http://albania.rec.org>
www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDi

- Dita anti-makine ne Tiranen e pluhurosur
- “Dita pa makina”, Bashkia e Tiranës sensibilizon qytetaret
- Arseniku i Fierit kthen syte nga Brukseli
- Kryeinspektori Kurti: Bashkia, taksa per ndotjen nga sqfuri!
- Liqeni i Tiranës kthehet ne kenete
- Flaket shkrumbojne pyllin ne periferi te Elbasanit
- Durres, bashkia, projekt per riparimin e siperfaqeve te gjelbra

NGA BOTA

- Udheheqes boterore mblidhen ne Nju Jork per te diskutuar per klimen
- Kerkohet me shume perparim lidhur me vrmen e ozonit.

Njoftime

- Seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit
- 11th international specialized conference on watershed & river basin management

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivitetet per mjedisin, jane te mirepritura te dergojne informacione ose njoftime, ne adresen 'Mjedisi Sot' info@albania.REC.org, ose Kutia Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

Dita anti-makine ne Tiranen e pluhurosur
Edmond Arizaj, Gazeta Shqiptare, fq. 21

Dita e shtune dhe e diele ne Tirane konsiderohet si dite 'e lire'. Kjo ne rradhe te pare nga drejtuesit e makinave, qe nuk u duhet te shfryjne rradheve te gjata ne semafore, apo ne kembe te policeve te qarkullimit, si ditet e zakonshme te javes. Por ja qe per ditet e djeshme, e shtune 22 shtator, kush e di se kush kishte menduar ta quante ditet pa makina. E ne 'nderim' te kesaj dite, bllokohet bulevardi 'Deshmoret e Kombit', arteria kryesore e qarkullimit ne kryeqytet. Kush pati fatin e keq dje te levizte ne orarin e percaktuar te bllokimit, duhet te kete vene re nje rremuje totale ne qarkullim, nje inat dhe nje mllef, I cili shfryhej me pa te drejte kunder makinave dhe motoreve te policise qe kishin ndaluar ne hyrje daljet e bulevardit.

Dakort qe keta zoterinjte tane kerkojne te bejne gjera te vecanta ne kryeqytet. Por a I kane kushtet, madje a I kane krijuar kushtet per nje dite pa makina, apo qofte edhe nje ore pa makina?! Cilat jane rruget dytesore ku duhet te kalonin dje makinat? Ku eshte unaza gjigande e Tiranes qe do te perballonte oret e bllokimit? Pse keta zoterinjt (kushdo qofshin) e kerkojne me kembengulje piken e fundit te durimit te qytetareve te tyre?

U mesua tashme se te ecesh me bicikle, apo edhe ne kembe eshte shume here me mire se me makine. Por, ku e paskemi ne shqiptaret kete komoditet? Mos duhet te ecim ne kembe e me dyrrotesha e ne fund te dites mushkerite te kthehen ne beton arme? Kur na qenka pastruar Tirana nga plehrat e kur na qenka mbushur me parqe qe ne te shetisimin e bredhojme me bicikle? Ketu te zihet fryma nga pluhuri, nga era, te ngjiten kembet nga balta, te plas shpirti nga rruget e pashtuara; ndersa zoterinjte si per ta plotesuar gjithë ironine e talljen e tyre te perditshme, transmetojne edhe komedine 'dita pa makina'.

Para pak muajsh nje minister i sapoardhur ne detyre nderrmorri nje tjetër cudi, si kjo e dites pa makina. Antiduhani. Niste kjo lufte qe nga institucionet, teresisht e pranueshme, e deri ne mejhanet me te fundit te ku pronari i lyster deri ne brryla me te perbrendshme qingji, me gishterinjte e mustaqet e zverdhura, te thoshte me keqardhje se duhet te qendroje ne karrigen me tre kembe jashte, se brenda nuk pije dot duhan. Se vinte kontrolli I rrepte I ministrise se shendetesise e te gjobiste me fitimet e nje muaji. Kjo ishte cudia me e madhe. Duhanpiresit nisen te trajtohen si lebroze ngjites, e te 'perziheshin' nga cdo ambient, e ne jo pak raste ka pasur edhe perplasje. Sepse keto jane cudite shqiptare. Nxjerr ligjin me ekstrem, por nuk merr asnje mase per te mbrojtur ata qe I prek ky ligj. Sepse tek e fundit edhe duhanpiresit jane njerez. Mos valle kjo ministria e shendetesise I detyroi te gjitha lokalet e Tiranes e me tej te kene vendet e vecanta per qeflinjte e duhanit? Problem I madh eshte dimri qe po afron dhe duhanpiresit qe nuk jane rralluar hic nga ligji novator. Do te rrine ne te ftohte dhe te behen keshtu kontigjent per ministrine e shendetesise, apo do te perballen me pronaret e lokaleve qe ende nuk u ka ikur frika e kontrolleve. Apo ministria do te beje nje sy qorr e nje vesh shurdh, e do te nise te merret me problemet e verteta te saj.

Ligje te tilla si antiduhani, apo dite si anti-makina, me nje Shqiperi cope cope dhe nje Tirane gjysem

pluhur, e gjysem beton, sikur nuk shkojne shume. Mire do te ishte qe zoterinjte te nderrmerrnin iniciativa per te kthyer buzeqeshjen tek qytetaret e tyre, e jo per t'i ngrysur ata edhe me shume, me manite e tyre europiane.

“Dita pa makina”, Bashkia e Tiranës sensibilizon qytetaret
Gazeta Shekulli, fq. 11

“Te ecurit dhe te sjellurit si kembesore dhe perdorimi i burimeve alternative te levizjes” eshte slogani i zgjedhur kete vit per “Diten pa Makina”. Tashme, Bashkia e Tiranës e ka kthyer ne nje tradite promovimin e Diteve Nderkombetare ne Mbrojtje te Mjedisit, sigurise se njerezve ne rruge dhe rritjes se cilesise se jetes se tyre. Ne kete kuader te Levizjes 16 – 22 shtator dhe “Dites pa Makina” bashkia organizoi aktivite, nepermjet te cilave synohet ndergjegjesimi dhe reflektimi i komunitetit ne mbrojtje te mjedisit dhe cilesise se ajrit, si faktore te rendesishem ne jeten e njerezve.

Numri i qyteteve pjesemarrese eshte rritur nga viti ne vit, dhe ne vitin 2006 numri i qyteteve pjesemarrese ka arritur ne mbi 1300 qytete. Ne aktivitet ishte i pranishem dhe Drejtori i Kabinetit te Bashkise se Tiranës, Eduard Shalsi, i cili tha se Tirana prej disa vitesh tashme eshte pjese e rrjetit te qyteteve dhe kryeqyteteve evropiane qe organizojne Javen Evropiane te Levizjes. “Bashkia e Tiranës, se bashku me shoqaten per Zhvillimin e Politikave Mjedisore, synon te terheqe vemendjen mbi aspektet negative te rritjes se numrit te makinave dhe levizshmerise me to”, - u shpreh Drejtori i Kabinetit te Bashkise se Tiranës.

Arseniku i Fierit kthen syte nga Brukseli
L. Cekoalija, gazeta Shekulli, fq. 8

Sasia prej 840 tone arsenik ndodhet ende ne gjendje te ngurte ne magazinat e ish- azotikut te Fierit duke krijuar nje rrezik serioz per te gjithë zonen. Ai duhet te asgjesohet por mungesa e fondeve ka bere qe cdo dite rreziku i tij te shtohet. Sipas nje informacioni te marre ne zyrat e kesaj uzine, mesohet se projekti per asgjesimin e tij tashme eshte percjelle ne Komitetin European per gjetjene donacioneve. Per groposjen e nje sasie kaq te madhe helmi nevojiten me shume se nje milion euro. Arseniku, i cili ndodhet i ngurtesuar, do t'i nenshtrohet procesit te izolimit ne nje grope ekologjike qe do te ndertohet brenda territorit te kesaj uzine, ne nje siperfaqe prej 60 hektarësh.

Parashikohet qe viti i ardhshem do te shenoje edhe fazen e fillimit te procesit te groposjes te mbetjeve te ngurtesuara te arsenikut. Pak kohe me pare, ka perfunduar studimi topografik dhe hidrik i zones ku do te ngrihet ky landfill si ne siperfaqe ashtu edhe ne thellesi te shtresave te tokes, ku eshte percaktuar edhe shkalla e kontaminimit. Firma fituese nga Komiteti European “G&G” ka perfunduar perpunimin e te dhenave te analizave mjedisore nderkohe qe firma tjeter “agrokonsulteurop” do te kryeje pas ketij investimi ne forme granti nepermjetdonacioneve te Komitetit European. Pas ndertimit te ketij landfilli, zona perreth do te marre formen e nje mjedisi te gjelberuar por jo per perdorim banimi. Eshte parashikuar qe zona perreth, ku do te ngrihet ky landfill, perfshin edhe shkaterrimin e pjeseve te tjera te uzines te kontaminuar. Ndertimi i tij do te behet i mundur sipas parametrave mjedisore dhe teknike te mbikeqyrura edhe nga Komiteti European.

Kryeinspektori Kurti: Bashkia, taksa per ndotjen nga squfuri!
Gazeta Shqiptare, fq. 8

Sipas kreut te Inspektoriatit Qendror Teknik, Ilir Kurti, organet e pushtetit vendor duhet te vendosin taksa shtese, per te dekurajuar konsumatorët nga perdorimi i gazoilit me cilesi me te ulet ne treg. Ne nje interviste per Gazeten ai ka vene ne dukje se ne te gjithë boten perdoren mjete te tilla administrative nga ana e bashkive dhe komunave, per te ndikuar ne uljen e ndotjes se zonave te rrezikuara nga nje ndotje e theksuar. Tirana, sipas institucionit qe drejton ai, sipas Kurtit, rezulton te jete nje nder rajonet e Shqiperise me ndotje shume te larte nga squfuri, qe eshte nje substance kancerogjene, e cila qarkullon ne sasi gjithnje e me te larte ne ajer, e leshuar nga tubat e shkarkimit te gazrave te automjeteve, thote ai. Sipas kryeinspektorit, ne vendin tone, sipas ligjit, ende lejohet te tregtohet nje cilesi gazoili, si ajo e prodhuar nga uzina e Ballshit, qe ka deri ne 2 per qind squfur ne perberjen e tij kimike. Sasi shume here me e larte se ajo e lejuar ne vende te ndryshme te Bashkimit European, ku Shqiperia synon te aderoje. Por, edhe nga ajo e lejuar ne vendet fqinje. Edhe eurodieseli, thekson ai, tek ne lejohet ne nivel 350/mije njesi squfuri, nderkohe qe ne vendet perendimore ky raport eshte deri ne 50 per mije. Pra, 7 here me pak. Kurti thekson se nje mase e marre, ne rradhe te pare, nga Bashkia e Tiranes, ku qarkullojne rreth 100 automjete ne dite, per te taksuar direkt shitjen e karburantit me pak cilesor, do te ndikonte dukshem ne pakesimin e ndotjes se ajrit ne kryeqytet.

Liqeni i Tiranes kthehet ne kenete
Gazeta Shqiptare, fq. 13

Liqeni Artificial i Tiranes cdo dite e me shume po i ngjan nje kenete. Renia e nivelit te ujit per shkak te thatesires si dhe shtimi gjithnje e me shume i siperfaqes mocalore, te jep nje pamje te trishtueshme te ketij liqeni. Edhe pse kjo eshte nje zone e mbrojtur, ky liqen po shkon drejt tharjes per shkak te abuzimeve qe bejne lavazhet prane liqenit te Tiranes si dhe mungesa e kanalizimeve te ujerave te zeza te pallateve prane tij. Liqeni i Tiranes, qe dikur ishte nje oaz per kryeqytetasit, tani nuk frekuentohet me per shkak te pamjes se tij, e cila le per te deshiruar. Ndotsit kryesore te ketij liqeni jane ujerat e zeza te pallateve dhe te lokaleve qe jane bere prane tij. Ata qe vuajne me shume degradimin e liqenit jane banoret e Tiranes, te cilet ne fundjave, per t'u larguar nga zhurmat dhe pluhurat e kryeqytetit, drejtoheshin nga kodrat e Parkut Kombetar dhe nga liqeni, gje qe nuk mund ta bejne me. Pasi ambientet e tij po behen te pafrekuentueshme jo vetem nga pamja e tij qe te le per te deshiruar, por dhe nga aroma e ujit si dhe insektet e shumta qe mblidhen nga papastertia. Specialiste te mjedisit kane shpjeguar se nese per liqenin nuk do te merren masat e nevojshme, atehere shume shpejt ai do te kthehet ne nje kenete dhe do te jete shume e veshtire te rikthehet serish ne gjendjen e tij te dikurshme. Sazan Guri ka shpjeguar se "ujerat e zeza qe derdhen ne liqenin e Tiranes, po shtojne cdo dite e me shume balten ne fund te tij, duke e cuar drejt tharjes". Nderkohe, nje shkak me shume per ta kthyer kete liqen ne nje terren mocalor ka qene thatesira e madhe e periudhes se veres si dhe mungesa e shirave ne kete fillim vjeshte. Bashkia e Tiranes deri tani ka marre masa vetem per ndalimin e qarkullimit ne kodrat e liqenit, pasi duke qene nje zone e mbrojtur, kalimi i automjeteve eshte i ndaluar. Po i njejti institucion ka deklaruar se per Liqenin Artificial kane nje projekt madheshtor, ku per transformimin e ketij parku, nje skuader e tere arkitektesh shqiptare dhe te huaj, do te dizenojne te gjitha detajet qe do te ndryshojne fytyren e Liqenit Artificial dhe te hapesires perreth, por deri tani nuk eshte bere asgje, edhe pse liqeni eshte drejt tharjes.

Flaket shkumbojne pyllin ne periferi te Elbasanit
Fatmir Popja, Gazeta Shqiptare, fq. 18

Nje vater e re zjarri ka alarmuar policine e zjarrfikesen e qytetit te Elbasanit kete fundjave. Flaket kane perfshire shkurre e pisha te masivit te gjelber ne periferi te qytetit. Si pasoje e ketij zjarri eshte djegur plotesisht nje siperfaqe e konsiderueshme prej 3 dynymesh, kryesisht me peme. Me gjithë nderhyrjen e zjarrfikesve, flaket kane bere punen e tyre me ore te tera, pasi permasa e tyre kishte dale thuajse jashte kontrollit. Policia ka nisur hetimet per kete ngjarje. Paraprakisht dyshohet qe zjarri te jete vene ne menyre te qellimshme, megjithate, deri dje blute nuk kane pasur asnje person te identifikuar si autor te kesaj zjarrvenie. Dyshohen edhe disa barinj te zones, por nuk ka asnje te ndaluar apo shoqeruar per kete ngjarje.

Banoret e zones perreth ku ka rene zjarri, kane lajmeruar zjarrfikesen menjehere pasi kane vene re se vendi po perfshihej nga flaket. Sipas burimeve zyrtare, mesditen e te dieles nga nje zjarr i fuqishem qe ka rene ne vendin e quajtur "Teqe e Krastes", jane djegur ne nje kohe te shkurter mese 3 dynym shkurre e pisha te masivit te gjelber, ne periferi te qytetit te Elbasanit. Me gjithë nderhyrjen e shpejte te sherbimit te zjarrfikesve, zjarri ka arritur te izolohet me veshtiresi, pasi flaket jane perhapur me shpejtesi ne nje siperfaqe te konsiderueshme, per shkak te eres se forte qe ka mbizotuar ne ato momente. Per nje fare kohe, zjarrfikesit e kane pasur te pamundur nderhyrjen ne zonen e perfshire nga zjarri, pasi terreni i veshtire e pengonte mjaft punen e tyre. Me zbutjen e shpejtesise se eres, zjarrfikesit kane mundur ta shuajne plotesisht zjarrin, por pa mundur te shpetojne nje siperfaqe te konsiderueshme pylli, demet e se ciles sipas eksperteve, jane mjaft te renda. Kete vit, vatrat e zjarreve ne qarkun e Elbasanit kane sjelle deme teper te medha. Shumica e rasteve jane shenuar nga barinj te zonave apo persona te tjere te papergjegjshem, te cilet i kane vene zjarrin vendit ne menyre te qellimshme.

DURRES Bashkia, projekt per riparimin e siperfaqeve te gjelbra
Gazeta Shqiptare, fq. 16

Ndermarrja e Pastrim-Gjelberimit, e cila funksionon prane Bashkise se Durrësit ka nisur zbatimin e nje projekti i cili synon riparimin e lulishteve si dhe shtimin e gjelberimit ne to. Sipas drejtorit te kesaj ndermarrjeje, Luan Zaza "te gjitha lulishtet ekzistuese do te pajisen me sistem hidrik, ne menyre qe te mundesohet vaditja e tyre. Pas ketij procesi, te gjitha siperfaqet do te punohen, do te pleherohen e do te mbillen me bime dekorative. Ndersa ne nje pjese tjeter do te krijohen tapete bari te cilat do te gjelberojne gjate gjithë vitit. Fillimisht puna ka nisur ne lulishtet te cilat ndodhen ne qendren urbane, si prane bashkise ashtu dhe prane pallatit te kultures, te cilat po pershkohen nga tubacionet e ujit dhe me pas do te kalohet ne lulishtet e lagjeve. Kjo eshte nje nisme e cila synon qe te krijoje edhe siperfaqe te tjera te reja te gjelbra, pasi Durresi eshte nje nder qytetet qe ka me pak gjelberim per numer popullsie ne shkalle vendi. Sipas drejtorit te Ndermarrjes se Pastrim- Gjelberimit, shume shpejt ne Durres do te kete shume lulishte te reja.

NGA BOTA

Udheheqes boterore mblidhen ne Nju Jork per te diskutuar per klimen

Udheheqes prej me shume se 80 vendeve po mblidhen ne qytetin e Nju Jorkut per te diskutuar mbi ndryshimin e klimes.

Zyrtari kryesor i OKB-se per klimen, Ivo de Boer, i tha Zerit te Amerikes se do te jete shume e rendesishme qe vendet afrikane te marrin pjese ne takimin e se henes per klimen dhe te bejne thirrje per ndihme.

Nder tema qe do te trajtohen ne takimin e organizuar nga OKB-ja do te jene financimi, ulja e sasive te dioksidit te karbonit qe clirohet ne atmosfere dhe teknologjia e re.

Ndryshimi i klimes, i cili njihet ndryshe edhe si ngrohje globale, eshte rritja e temperaturave ne te gjithë globin, e cila besohet se shkaktohet kryesisht nga clirimi i dioksidit te karbonit ne atmosfere. Nje raport i fundit nga Komisioni Nderqeveritar i Ndryshimit te Klimes thoshte se Afrika eshte ne gjendje me te dobet per shkak te ultesirave te saj bregdetare dhe kushteve te renda te prodhimit bujqesor te cilat i bejne thatesirat dhe permbytjet me te dendura.

Sekretari i pergjithshem i OKB-se Ban Ki Moon thote se ai do te arrije nje marreveshje te re per ndryshimin e klimes deri ne vitin 2009.

Per me shume informacion:

<http://www.voanews.com/albanian/2007-09-23-voa7.cfm>

Kerkohe me shume perparim lidhur me vrmen e ozonit.

Duke shkruar ne faqen e internetit te BBC News, Joe Farman kerkon nxjerrjen jashte perdorimit sa me shpejt te disa kimikateve qe shkaterrojne ozonin.

Protokolli i Montrealit, rregullatori i ketyre substancave, eshte 20 vjecar tashme.

Disa prej argumenteve te Dr. Farman jane perseritur shpesh nga personalitete te medha te Kombeve te Bashkuara, si dhe nga politikane evropiane dhe amerikane.

Dr. Farman eshte kritik i marreveshjes qe lejon vendet ne zhvillim te perdorin disa kimikate te qe hollojne shtresen e ozonit deri ne vitin 2040. "Rishqyrtimet e vazhdueshme e shpetojne Protokollin e Montrealit nga mangesite e planit origjinal dhe eshte mjaft e nevojshme nje rishqyrtim tjetër i hollesishem", shkruan z. Farman.

Joe Farman ishte nje prej tre shkencetareve angleze qe studio Antarktikon, duke raportuar demtime te renda ne shtresen e ozonit mbi Antartik -vrime e ozonit- ne 1985.

Vendet pale te Protokollit te Montrealit jane mbledhur javen e kaluar, perseri ne Montreal, per te rishqyrtuar progresin e deritanishem te marreveshjes.

Per me shume informacion:

<http://news.bbc.co.uk/2/hi/science/nature/6998489.stm>

Njoftime

seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave te Shqiperise dhe UNDP Shqiperi do te organizojne seminarin permbylles "Shqiperia – Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit" (NCSA) ne 27 Shtator, 2007, ne Hotel "Tirana International". Seminari fillon ne oren 10:00.

Plani Strategjik i Veprimit eshte mbeshtetur ne fushat e perbashketa te tre Konventave te Rios, permes vleresimit dhe analizes se nevojave prioritare te vendit per zbatimin e Konventave Globale Mjedisore dhe pasqyron ne terma praktike aktivitetet qe duhet te ndermerren per krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe te strukturave mbeshtetese me qellim menaxhimin e koordinuar e

strategjik te mjedisit ne Shqiperi. Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve do te krijoj nje mjedis lehtesues per ruajtjen e biodiversiteti unik te vendit, do te lehtesoje zbutjen e vulnerabilitetit nen kushtet e ndryshimeve klimatike si dhe do te ndihmoje ne koordinimin e masave qe duhen marre per te luftuar shkretetirizimin dhe degradimin e tokes, duke ndihmuar ne te njejten kohe zbatimin e parimeve te zhvillimit te qendrueshem.

Pjesemarresit e seminarit jane perfaqesues te Ministrive te linjes, institucioneve kerkimore dhe arsimore, eksperte kombetare, OJF, si dhe perfaqesues te institucioneve financuese.

Per me shume informacion kontaktoni:

Klodi Marika

NCSA/SLM

Manager

klodi.marika@undp.org

11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management

The International Water Association is going to organize 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management on 4-5 September 2008 in Budapest.

The Call for Papers in electronic form (CfPe) which gives a summary of the most important information about the conference can be found on: www.iwa2008budapest.org

Water is a challenge for the century.

Exploring the sustainability of our most valuable resource is our business. IWA presents a unique opportunity to engage in 2 days of innovative discussion on the subjects of Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls and Monitoring and Modelling.

Join other experts in exchanging ideas and exploring networking opportunities during the IWA Watershed and River Basin Management Conference, 4-5 September 2008 in beautiful Budapest, Hungary. Mark this event on your calendar and begin to plan abstract / paper / poster today.

Topics of the Conference:

Include but are not limited to Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls, Monitoring and Modelling.

- River basin management planning under the EU Water Framework Directive;
- River basin management practices in different continents;
- Managing water resources in transboundary river basins with conflicting demand;
- Managing competing uses to protect water quality and quantity;
- Watershed management methods to facilitate water availability for aquatic ecosystem health and human uses;
- Interconnecting sub-watersheds to achieve basin goals;
- Hierarchical approaches to river basin management.
- Monitoring, ecological classification in EU countries and intercalibration;
- State-of-the-art in assessing water and biological quality and integrating data.;
- Programme of measures and ecological state.

- River basin management, advanced computation and decision support;
- The impact of climate change on watersheds, river basins, estuaries and reservoirs;
- Flood control and prevention.
- Effective methods to involve stakeholders and the public into the river basin management planning processes;
- Conflicts and multi-objective management – is it mostly methodology?
- Economics of River Basin Management.

The internet site of the conference is already open (www.iwa2008budapest.org) and interested candidates could submit abstracts under the Registration menu.

The abstract submission period is open until the end of September 2007.

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditore do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitetet mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>

www.mjedisisot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimpruese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrtare e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrtese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin

shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike.

Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
